



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1543 Prot.

Tiranë, më 10 / 11 / 2020

V E N D I M

Nr. 162, Datë 10 / 11 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.105, datë 25.09.2020, të paraqitur nga L. S, kundër Shërbimit Spitalor (SHS) Krujë, në të cilën pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër¹*”, “*bindjet politike*”, “*gjendjen arsimore*”, “*gjininë*” dhe “*vendbanimin*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues L. S, ka lidhur marrëdhënien e punës me Shërbimin Spitalor (SHS) Krujë që në vitin 1994, në detyrën e mjekut obstetër-gjinekolog, detyrë të cilën e ka kryer deri me datë 06.01.2020. Ai ka bërë një sërë trajnimesh dhe specializimesh brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të cilat ka bashkëlidhur dhe dokumentacion provues. Ankuesi shprehet se gjatë 30 viteve punë nuk ka patur asnjëherë probleme që lidhen me disiplinën apo me aftësitë e tij profesionale si mjek obstetër-gjinekolog. Ankuesi citon se: “*Me ardhjen në detyrë të drejtores së re të Spitalit Krujë, të Y.K, në fund të Qershorit 2018, kanë filluar edhe shqetësimet e para dhe diskriminimi ndaj meje, të cilat kanë patur si qëllim në vetvehte krijimin e kushteve të vështira në punë që t’i paraprinin largimit tim përfundimtar, në mënyrë që ajo të kishte dorë të lirë t’u krijonte favore preferenciale të pamerituara dy mjekëve të tjerë, njëkohësisht duke*

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

eliminuar dhe konkurrencën e ndershme”. Nëpërmjet Urdhrit nr.1, datë 06.01.2020 drejtorja e Spitalit Krujë ka urdhëruar shpërndarjen e menjëhershme të marrëdhënieve kontraktuale të punës. Ankuesi shprehet se në organikën e Spitalit rezultojnë 3 (tre) pozicione mjek obstetër-gjinekolog, me dy mjekë në detyrë dhe një vend vakant. Ndërkohë që me heqjen nga puna të ankuesit, Spitali mbetet me vetëm një mjek obstetër-gjinekolog. Ankuesi citon se: *“Vetëm dy muaj pas ardhjes në detyrë, drejtorja ka tentuar të më largojë nga puna me çdo kusht, për motive që vetëm ajo i di dhe që sigurisht derisa nuk bëhen publike, janë të atij lloji që ligji i ndalon”*.

Ankuesi shprehet se, drejtorja e Spitalit, me qëllim për të justifikuar largimin e tij i ka dhënë disa masa disiplinore njëra pas tjetrës, të cilat ai i gjykon si tendencioze dhe të qëllimshme ndaj tij, duke pretenduar se është diskriminuar në marrëdhënien e punës nga punëdhënësi.

Masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit në rend kronologjik janë:

- Nëpërmjet Urdhrit nr.20, datë 12.07.2018 “Për masë disiplinore” i është dhënë masa disiplinore “Këshillim”, për mosrespektim të rregullave dhe etikës në punë. Ndërkaq, me datë 30.10.2018 i është dërguar njoftimi për bisedime për t’u njohur me ndryshimin e marrëdhënieve të punës.
- Nëpërmjet Urdhrit nr.11, datë 28.01.2019 “Për masë disiplinore” i është dhënë masa disiplinore e gjobës në masën e një dite pune, për mungesë të pajushtimit në vendin e punës.
- Nëpërmjet Urdhrit nr.18, datë 19.02.2019 “Për masë disiplinore” i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, për mungesë pa arsye në vendin e punës, të përsëritur, si dhe për sjellje jo etike dhe jo profesionale.
- Nëpërmjet Urdhrit nr.87, datë 11.11.2019 “Për masë disiplinore” i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për mungesë të pajustificuar në vendin e punës.

L. S i ka kundërshtuar të gjitha këto masa disiplinore duke parashtruar argumente se ka qenë prezent në vendin e punës, në ambjentet e Spitalit dhe për të gjitha rastet ka depozituar në cilësi prove regjistrime audio(cd) ku evidentohen kundërshtimet e tij për secilin rast.

Ankuesi pretendimin për diskriminim të drejtëpërdrejtë të drejtores së Spitalit ndaj tij, e argumenton me faktin se ajo ka emëruar në krye të Shërbimit Obstetër-Gjinekologji një mjek neonat, duke diskriminuar në këtë mënyrë të gjithë mjekët obstetër, pasi ai nuk ka njohuritë e nevojshme për organizimin profesional të këtij shërbimi, duke treguar lidhjet preferenciale dhe të pamerituara. Ai citon se: *“Drejtorja, qëndrimin e njëanshëm dhe preferencial ndaj neonatit e shpreh dhe me tolerimin që i bën atij lidhur me vonesat në punë, ndërkohë që mua për 10 minuta vonesë më ka pushuar nga puna, duke më viktimizuar në këtë mënyrë”*.

Po ashtu, ankuesi ka evidentuar dhe një konflikt të ndodhur mes tij, mjekes obstetere R.T dhe bashkëshortit të saj, i cili ka agravuar deri në goditjen fizike ndaj z.S. Lidhur me këtë incident, ankuesi shprehet se në vend që drejtorja të merrte masa ndaj mjekes R.T, ka ndëshkuar atë me masë disiplinore, ndërkohë që bashkëshorti i mjekes ka konsumuar vepër penale ndaj ankuesit.

Ankuesi pretendon se diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj tij ka kulmuar me procedurën antiligjore të largimit të tij nga detyra, në shkelje të zbatimit të afatit të zgjidhjes së kontratës së punës, të mënyrës dhe formës të procedurës për zgjidhjen e kontratës.

Diskriminimin e tij nga ana e drejtores, ankuesi e argumenton si më poshtë:

- Me shkresën me nr.946 prot., datë 30.10.2018 ankuesi shprehet se drejtorja ka nxjerrë Urdhrin për largimin e tij nga puna.
- Me shkresën me nr.947 prot., datë 30.10.2018 drejtorja ka nxjerrë Urdhrin nëpërmjet të cilit ka vendosur që çdo aktivitet instrumental, abrazio, kryetazhe, biopsi, lindje nuk duhet kryer pa miratimin e Përgjegjësit të Maternitetit. Në momentin e nxjerrjes së këtij urdhri ankuesi shprehet se kanë qenë vetëm dy mjekë obstetër, ai dhe mjekja R.T, Përgjegjëse e Maternitetit. Ankuesi pretendon se nëpërmjet këtij urdhri, drejtorja ka patur për qëllim të kufizojë punën e tij, pasi dr. R.T në pozicionin e Shefes nuk i përdor asnjëherë këto mjete dhe mundohet të pengojë ankuesin në ushtrimin e detyrës së tij.
- Po ashtu, ankuesi pretendon si diskriminim të tërthortë edhe ndryshimin e listës së rojeve, sipas dëshirës së drejtores dhe interesave të mjekëve të tjerë.

Diskriminimin ndaj tij, ankuesi e ka evidentuar nëpërmjet organizimit të qëllimshëm të mbledhjeve me mjekët, duke nxitur apo udhëzuar mjekët e tjerë për të diskriminuar atë. Kështu ai ka cituar (bashkëlidhur cd e audios së mbledhjes) procesverbalin e datës 19.09.2019 nëpërmjet të cilit ka pretenduar se provohet haptazi tendenca e drejtueses së Spitalit për ta larguar atë nga puna nëpërmjet krijimit të situatave absurde. Në këtë takim ishin ftuar mjekët e tjerë, ndërsa ankuesi jo.

L. S ka pretenduar diskriminim nga drejtorja e Spitalit edhe përsa i takon mbylljes së Shërbimit të Kolposkopisë, duke argumentuar se kjo gjë erdhi për egon dhe ambicjen profesionale të mjekes R.T, e cila meqë nuk dinte ta përdorte këtë aparaturë, e mbylli këtë shërbim me pretekstin se është “luks” për Maternitetin e Krujës, duke diskriminuar edhe të gjitha gratë e këtij rrethi, pasi i përjashtonte ato nga kontrolli i sëmundjeve malinje.

Po ashtu, ankuesi ka cituar se, drejtorja në mbledhjen e datës 07.01.2019 ka shkelur haptazi ligjin për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë, duke u bërë thirrje të hapur mjekëve që rastet ti dërgonin në spitale private, por jo në spitalet shtetërore të Tiranës apo Durrësit, me argumentin se edhe ato “do merrnin pjesën e tyre”. Në këtë kontekst, ankuesi shprehet se, drejtorja e Spitalit ka bërë thirrje për mosdhënie shërbimi dhe kalim të pacientëve në spitalet private, në mënyrë që të përfitonte të ardhura të pamerituara, duke diskriminuar në këtë mënyrë edhe pacientët përmes mosmarrjes së shërbimit në spital.

Ankuesi ka cituar si vijim të diskriminimit ndaj tij edhe mbledhjen e datës 31.12.2019, për të cilën shprehet se: *“Me datë 23.12.2019 sipas listës së miratuar të mjekëve rojë, në shërbim ishte mjekja R.T, e cila sipas ankuesit nuk ishte në punë, por u justifikua nga drejtorja sikur kishte marrë leje nga ajo për 2 orë”*. Ndërkohë ankuesi shprehet se është njoftuar se janë paraqitur

njëkohësisht dy gra, njëra me hemoragji, gjë që përbënte rast urgjent dhe tjetra me aktivitet lindjeje. Ankuesi, duke vlerësuar si më urgjente rastin me hemoragji i ka dhënë asaj ndihmën e parë, pastaj konsultoi rastin e dytë dhe meqenëse lindja ishte parashikuar të ndodhte më vonë ia la si detyrë kryemamisë që të informonte mjeken e rojes. Ai shprehet se drejtorja është munduar të shfrytëzojë këtë rast për ta diskriminuar atë, duke e paraqitur rastin si mos dhënie ndihme dhe rrezikim të jetës së gruas dhe fëmijës edhe pse në kartelën mjekësore përshkruhet nga vetë dr.R.T se: *“Gruaja lindi shumë mirë dhe fëmija po ashtu. Mbas dy ditësh gruaja dhe fëmija dolën nga spitali në gjendje shumë të mirë”*.

Ankuesi shprehet se drejtorja ka larguar atë nga puna dhe në kushtet kur mjekja R.T banon në fshatin Derven të Fushë-Krujës dhe nuk mund t’i përballojë urgjencat obstetrikale duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e pacientëve. Ai citon se, me datë 09.06 2020 (periudhë gjatë së cilës ai ka qenë i larguar nga puna) ka ndërruar jetë një foshnjë për mosdhënie ndihmë dhe ky rast as nuk është diskutuar fare, ndërkohë që duhej bërë ekspertizë mjeko-ligjore për rastin.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga KMD:

- *Të konstatojë diskriminimin e tij nga punëdhënësi.*
- *Të rikthehet në detyrën që ka patur si mjek obstetër-gjinekolog në SHS Krujë.*
- *Ti vërë sanksion me gjobë në shumën prej 80 000 lekësh drejtueses së SHS Krujë, si personi që ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkeljet bazuar në LMD”*.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 23.09.2020, specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, pranë Zyrës së KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet e-mailit të datës 23.09.2020 subjekti ankues ka dërguar dokumentacionin plotësues, dhe lidhur me shkaqet e pretenduara ka shpjeguar se: *“Në kontekst të interpretimit të shkaqeve sipas nenit 1, të LMD, në asnjë rast unë nuk mund të gjej në mënyrë nominale se nga vjen ky diskriminim, pasi siç dhe kuptohet drejtuesit e Institucioneve publike janë të informuar me ligjin përkatës dhe në asnjë rast ato nuk bëjnë publike se nga cili motiv buron ky diskriminim. Vetë neni 1, i këtij ligji parashikon “çdo shkak tjetër”. Gjithsesi për të qenë korrekt me ju, mund të mendoj disa motive nga niset kjo drejtuese në diskriminimin karshi meje, si:*

- *Vendbanimi (Konsiderohem “i huaj” për krutanët pasi jam me origjinë nga Korça)*
- *Arsimi, pasi jam i diplomuar, specializuar dhe me kualifikime pasuniversitare, në kundërshtim me drejtoreshën e Spitalit e cila është me arsim ekonomik.*

- *Gjinia (pasi unë jam burrë dhe jam mjaft i respektuar në Krujë dhe Fushë-Krujë dhe kjo nuk e lejon drejtoreshën të bëjë dallavere me mua).*
- *Mund të jenë edhe bindjet politike, pasi unë gjatë këtij 30 vjeçari nuk jam përzier me asnjë parti (në kundërshtim me drejtuesen që është militante partiake).*

Motive këto besoj që mund të kenë çuar atë të më diskriminojë mua”.

Në vijim, ankuesi nëpërmjet e-mailit të datës 15.10.2020 ka kërkuar që shqyrtimi i çështjes së tij të vijojë për shkak të bindjeve politike dhe origjinës së tij, duke cituar se: *“Jam diskriminuar nga drejtorja e Spitalit për shkak të bindjeve të saj politike dhe për shkak të origjinës sime”*, duke hequr dorë nga shkaqet e tjera të pretenduara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1271/3 prot., datë 13.10.2020 Komisioneri ka njoftuar subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa, DSHS Krujë dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

2. Me shkresën me nr.1030 prot, datë 03.11.2020 DSHS Krujë ka sjellë parashtime dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë³, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga L. S. për diskriminim nga ana e drejtores së DSHS Krujë është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri. Në citim të bazës ligjore, ankuesi i referohet Nenin 9, i Kodit të Punës, i ndryshuar “Ndalimi i diskriminimit”.

Në parashtimet e kërkesë padisë së bërë nga ankuesi pranë Gjykatës, ndër të tjera, në faqet 1-4 të saj, citohet se: *“Me ardhjen në drejtim të Spitalit Bashkiak Krujë, të shtetases Y.K, me profesion ekonomiste, kanë filluar shqetësimet e para karshi meje, shqetësime të cilat janë të pasqyruara në tendenca diskriminuese dhe diferencuese të kësaj drejtueseje, me qëllim krijimin e kushteve të vështira në punë, për të më krijuar një situatë mbytëse që unë të largohesha. Duke qenë profesionist i vjetër dhe në kushtet e një përvoje shumëvjeçare, i kam anashkaluar këto tendenca diskriminuese të kësaj drejtueseje, duke vijuar punën time për dhënien e kujdesit mjekësor. Duke parë indiferencën time karshi veprimeve të saj diskriminuese, me qëllim për të krijuar mundësinë e largimit tim nga puna, kjo drejtuese ka dhënë disa masa qesharake ndaj meje si mjek.*

Në kuadër të qëllimit të saj diskriminues, i cili mund të vijë për motive të ndryshme, si: politike, gjinore, krahinore, etj, të cilat Kodi i Punës i ndalon si shkaqe për zgjidhjen e kontratës së punës, nga ana e drejtores është bërë përpjekje të krijohen shkaqe të ashtëquajtura të justifikuara për të realizuar qëllimin e saj për të më larguar nga puna.

Duke ju referuar aktit të prishjes së kontratës së punës, në asnjë rast nuk evidentohet se cila është shkelja e bërë dhe pasoja e ardhur, gjë që provon në mënyrë të drejtëpërdrejtë se një veprim i tillë nga ana ime nuk ekziston, por që është bërë me qëllim për të justifikuar zgjidhjen e kontratës së punës për shkaqe diskriminuese.

Lënia e Spitalit të Krujës vetëm me një mjek obstetër, duke më larguar edhe mua nga puna, kur në organikën e këtij Spitali ka tre mjekë obstetër, bën të pamundur dhënien e shërbimit për pacientët, dhe kjo pasojë e rëndë vjen nga veprimet e papërgjegjshme të drejtueses së Spitalit, e cila, për qëllime diskriminuese, politike, gjinore apo lokale kërkon të godasë punonjësit e institucionit që ajo drejton”.

³ Në vijim: Gjykatës

Bazuar në sa më sipër, L. S, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ka pretenduar trajtimin e disfavorshëm dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve politike, gjinore, krahinore, lokale, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”*

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime dhe prova janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr.105 Regj., datë 25.09.2020 të L. S dhe deklaroi të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e saj.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

Ndërsa, lidhur me pretendimin e ankuesit se nga ana e drejtueses së DSHS Krujë janë bërë shkelje dhe abuzime në ushtrimin e detyrës së saj, përse i takon pretendimit të tij se: *“Y.K ka*

bërë thirrje për mosdhënie shërbimi dhe kalim të pacientëve në spitalet private, në mënyrë që të përfitonte të ardhura të pamërituara, duke diskriminuar në këtë mënyrë edhe pacientët përmes mosmarrjes së shërbimit në spital”, si dhe faktit kur ai citon se: “Me datë 09.06 2020 (periudhë gjatë së cilës ai ka qenë i larguar nga puna) ka ndërruar jetë një foshnjë për mosdhënie ndihmë dhe ky rast as nuk është diskutuar fare, ndërkohë që duhej bërë ekspertizë mjeko-ligjore për rastin”; Komisioneri vëren se shqyrtimi i këtyre pretendimeve nuk bën pjesë në fushën e veprimtarisë së tij. Lidhur me sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet organeve kompetente për shqyrtimin e rasteve të tilla.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.105 Regj., datë 25.09.2020, të paraqitur nga L. S, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike dhe origjina)

(Fusha: Punësim)